



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.5.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e punës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2021” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Luljeta Bozo, Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Lefter Gështenja, Zef Hila, Agron Duka dhe Nusret Avdulla.

Mungojnë:

Tatiana Piro, Rrahman Rraja, Flamur Hoxha, Fatjon Veizaj, Ramadan Likaj dhe Xhelal Mziu.

Të ftuar:

S’ka

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Mirëmëngjesi, kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit.

Sot në rendin e ditës, sikurse ju ka ardhur edhe në postat tuaja elektronike, kemi shqyrtimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e punës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2021”.

Ne jemi komision përgjegjës.

Relator është zoti Laert Duraj.

Draftrezolutën ju ka kemi dërguar në postën tuaj elektronike.

Zoti Duraj, ju lutem, përqendrohu në gjërat kryesore që ka draftrezoluta dhe më pas vazhdojmë me diskutimet për këtë çështje.

Laert Duraj – Faleminderit, të nderuar kolegë!

Në cilësinë e relatorit po ju paraqes draftrezolutën e komisionit tonë për punën dhe veprimtarinë e AKEP-it.

Kuvendi i Shqipërisë, duke njohur AKEP-in si autoritet të pavarur në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike e postare dhe në ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor, si dhe duke vlerësuar shumë nga veprimtaritë e AKEP-it, ka vlerësuar:

- punën e bërë nga AKEP-i për zbatimin e marrëveshjes rajonale të *roaming*-ut, e cila ka bërë të mundur “*Roaming like at home*” në Ballkanin Perëndimor, duke filluar nga 1 korriku i vitit 2021;

- impenjimin e AKEP-it në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit;

- monitorimin e bërë nga AKEP-i për përmbushjen e rekomandimeve nga sipërmarrësit e rrjeteve celulare;

- bashkëpunimin e AKEP-it me Autoritetin e Konkurrencës;

- punën e bërë nga AKEP-i, si dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

- punën e bërë nga AKEP-i lidhur me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit me AMA-n;

- bashkëpunimin e AKEP-it, si pjesë e grupit të punës, të ngritur nga MIE-ja në kuadër të harmonizimit të legjislacionit në fushën e komunikimeve elektronike në përputhje me Kodin e ri Europian të Komunikimeve Elektronike.

Në këtë kuadër, Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 rekomandon që AKEP-i të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimtarisë së tij:

1. Të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin e Konkurrencës për të shmangur krijimin e një tregu oligopol.

2. Të ndjekë zbatimin e “Rregullores për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Përdoruesve të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike Publike”.

3. Të ndjekë dhe monitorojë me rigorozitet përmbushjen e rekomandimeve dhe detyrave të dhëna për secilin operator.

4. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, AKEP-i të monitorojë përmbushjen e detyrimeve nga Posta Shqiptare të dorëzimit të pakove në adresën e individit.

5. Të bashkëpunojë me MIE-në dhe me konsulentët e përzgjedhur për të realizuar në kohë projektin “Zhvillimi i Atlasit të Broadband në Shqipëri dhe përdorimi e tij në sektorin publik dhe privat”.

6. Të bashkëpunojë me AMA-n për finalizimin e procesit të lirimit të brezit DD2.

7. Të vijojë punën për nënshkrimin e marrëveshjes ndërkufitare me Republikën e Maqedonisë së Veriut për rrjetet 4G dhe 5G.

8. Të vijojë të ndjekë me përparësi problematikën për sistemimin e kabllave ekzistuese në shtyllat e energjisë elektrike.

9. Të vijojë bashkëpunimin me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

10. Të impenjohet intensivisht për të bërë të mundur zgjidhjen e problematikës së telefonatave të padëshiruara të kompanive të marketingut në drejtim të pajtimtarëve.

11. Të ketë prioritet të punës bashkëpunimin me MIE-në për ndryshimet ligjore në ligjin e komunikimeve elektronike.

12. Të fokusohet në realizimin e një vlerësimi të hollësishëm dhe me impakt afatgjatë të parametereve, kapaciteteve dhe instrumenteve tekniko-ligjorë për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve kritike në AKEP.

13. Të bashkëpunojë me AMA-n dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për qasje proaktive dhe sa më efikase në parandalimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe të dhunës në portalet e ndryshme *online*.

14. Të bashkëpunojë me të gjithë aktorët dhe institucionet përgjegjëse për të bërë të mundur që të mos ketë në vend shkolla pa akses në internet, sipas kushteve teknike dhe parametrave përkatës.

Këto ishin rekomandimet e komisionit tonë. Ju ftoj t'i votojmë.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Në fakt ne zhvilluam seancën e parë me drejtuesit e AKEP-it, ku diskutuam disa nga shqetësimet që dolën gjatë diskutimit, të cilat jemi përpjekur t'i marrim parasysh në këtë draftrezolutë.

Të nderuar kolegë, hapim diskutimet. A ka dikush ndonjë diskutim konkret për të shtuar apo për të hequr nga kjo draftrezolutë?

Atëherë më duhet të theksoj disa gjëra, të cilat i vumë re në mbledhjen e kaluar dhe që i kemi rifutur në këtë projektrezolutë.

E para ka të bëjë me impenjimin e vazhdueshëm që duhet të ketë AKEP-i, edhe në këtë periudhë, në lidhje me një situatë oligopoli që mund të ndodhë. Ky ishte një shqetësim që ne vazhdojmë t'jua rekomandojmë.

Po ashtu, kemi futur shqetësimin, që e diskutuam të gjithë bashkë, i cili është një shqetësim qytetar, në lidhje me sasinë e *gigabite* që japin ofertat, pra përputhjen mes asaj që ofrohet dhe asaj që realisht konsumohet.

Shqetësimi tjetër ka të bëjë me kabllo të shtrihen në ajër në qytet, duke krijuar atë “rrjetën e merimangave”, të cilin AKEP-i vazhdon ta ketë ende detyrim. Sigurisht kjo nuk varet prej tyre, e dimë këtë gjë, por nuk duhet ta heqim nga vëmendja këtë.

Unë e gjeta me shumë vend shqetësimin e zotit Mziu në lidhje me shkollat, që të luftojmë të mos kemi asnjë shkollë pa akses interneti dhe kjo është futur në këtë draftrezolutë. A ka diçka tjetër nga kolegët?

Në fakt, ne vazhdojmë ta theksojmë që AKEP-i duhet të punojë me Autoritetin e Konkurrencës; deri këtu ne mund të rekomandojmë, pastaj se si vepron tregu ajo është çështje e tregut. AKEP-i nuk duhet të humbasë bashkëpunimin me Autoritetin e Konkurrencës pikërisht

për atë fenomen që mund të na ndodhë, por edhe për atë që është e përditshme në konkurrencën mes operatorëve.

Po, zoti Zeqaj.

Baftjar Zeqaj – Problemet më kryesore që ju trajtuat, si për rrjetin ajror ashtu dhe për shkollat, janë dy shqetësime shumë të drejta, që për mendimin tim mund t’u vendosim një afat. Për shembull, nëse do të ketë një bashkëpunim të mirë me pushtetin lokal, mendoj se brenda një viti të gjithë “merimangat” hiqen, sepse nuk është ndonjë investim shumë i madh, nuk ka kosto, nuk është një barrë e rëndë, as për AKEP-in dhe as për pushtetin vendor.

E njëjta gjë edhe për shkollat, nëse do të vendosim që brenda 1 viti të gjitha shkollat të kenë internet, për mendimin tim do të ishte shumë mirë. Pra, janë 2 rezultate shumë të mira dhe të dukshme brenda 1 viti në të gjithë Shqipërinë. Pra, unë mendoj se nëse vendosim afate do të ishte shumë mirë, që të mos ngelet një sugjerim në parim.

Arben Pëllumbi – Zoti Zeqo, në fakt, kjo është projektrezolutë që ka afat 1-vjeçar dhe ne sugjerojmë që të bëhen këto gjëra. Pra, në fund të vitit që vjen ne do të rimarrim në shqyrtim aktivitetin e AKEP-it për vitin 2022, dhe do të shikojmë se sa është plotësuar rekomandimi që ne kemi bërë. Ne nuk mund t’i detyrojmë, sepse nuk është ligj që ne të vendosim afate, që ata të jenë të detyruar t’i zbatojnë. Po të keni parasysh, pika e “rrjetave të merimangave”, nuk është një pikë e vendosur këtë vit për herë të parë, por ka disa vite që vendoset në rezolutat që ne bëjmë dhe është një shqetësim, i cili ekziston, por nga krahu tjetër duhet të kemi parasysh se AKEP-i i vetëm, pa mbështetjen e pushtetit lokal dhe pa mbështetjen e disa aktorëve të tjerë, e ka të pamundur. Megjithatë, kemi një përmirësim të kësaj situate.

E rëndësishme është që qytetarëve t’u ofrojmë shërbimin e internetit, sepse pa të sot nuk jetohet. Ndërkohë, nga krahu tjetër, duke mos prishur këtë cilësinë e shërbimit për qytetarët, shikojmë mundësinë e largimit të këtyre rrjeteve, nëpërmjet kalimit ajror apo nga shtylla në shtyllë, për të mos shëmtuar pamjen e qytetit.

Po, zoti Bushati.

Helidon Bushati – Kam diçka që nuk ka lidhje specifike, por që mund të jetë në vijim të asaj që tha parafolësi. Praktikisht ky komision mbulon veprimtarinë e tri autoriteteve rregullatore, ERE, AKEP dhe ERU, që e kanë detyrim ligjor të paraqesin raportet vjetore një herë në vit. Ne këtu jemi për raportin e AKEP-it, por edhe kryetari i ERE-s shprehu dëshirën që të vinte në një seancë dëgjimore në këtë komision. Pra duke parë problematikat, mendoj që të

bëhet një lloj procedure (pa dyshim që asnjërit nga ne nuk i hiqet e drejta e dhënë nga ligji për të thirrur përfaqësuesit e enteve rregullatore), që entet të thërritet 2 herë në vit. Për shembull, AKEP-i do të ketë problematika. Unë mendoj se do të finalizohet procedura e rikonfigurimit të tregut me 2 operator, pra pavarësisht se ishte opsionale, unë mendoj se do të shkojë drejtë finalizimit. Kjo mund të sjellë efekte në treg, gjë që secili prej nesh e ngriti. Pra, a mund të jetë vendi për të thirrur AKEP-in në shtator, tetor ku do të ngrihet edhe pretendimi i zotit Zeqaj, edhe i yni. Mbase ne duhet të fillojmë me ERU-në, që ta thërrasim sepse me rikonfigurimin e sistemit të ujësjellësve do të ketë problematika. Ky komision duhet të jetë në dijeni dhe të diskutohet, meqenëse ka kaluar me VKM, por ky komision nuk ka qenë pjesë e kësaj vendimmarrje.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Bushati!

Në fakt ne e kemi biseduar dhe shumica e kolegëve e gjejnë me vend sugjerimin tuajin. Kam folur edhe me shërbimet e monitorimit të Kuvendit, edhe me këshilltarët tanë, ndoshta muaji shtator është muaji i përshtatshëm për të bërë një dëgjese me të tri entet, duke pasur parasysh që në shtator fillon sesioni i ri dhe ngarkesa jonë është më e vogël, prandaj mund ta bëjmë. Shtatori përkon me mesin e periudhës mes dy deklarimeve, pra e gjej me vend dhe do të shikojmë mundësinë që në shtator t'i bëjmë këto dëgjesa.

Po.

Ismet Beqiraj – Gjatë shqyrtimit në mbledhjen e mëparshme të komisionit, në raportin vjetor të veprimtarisë së AKEP-it, u ngritën dy probleme që kanë të bëjnë me shërbimin publik të lidhur me shërbimet postare, sepse shikoj që nuk janë shprehur te rekomandimet. Pavarësisht se atë ditë drejtuesi i AKEP-it e justifikoi që nuk është përgjegjësia e tyre, por tek e fundit mbase nuk e ka përgjegjësi direkt ekzekutive, por e ka Drejtoria e Përgjithshme e Postave. Në fund të fundit është një institucion që monitoron çdo shqetësim publik që lidhet me shërbimet që ai ka në varësi të fushës së përgjegjësisë si institucion së paku, por edhe në aspektin e rekomandimeve që ne bëjmë. Ngrita dy probleme për postën, të cilat nuk janë përfshirë. Posta Shqiptare ka bërë një përmbysje totale të veprimtarisë së saj përpara syve të publikuar dhe qytetarëve në shërbim dhe në interes të qytetarëve, si dhe shumë aktivitete. Një nga problemet që ngrita atë ditë lidhej me tensionet e qytetarëve, të cilat do të liberalizohen dhe do të merren në çdo sportel të postave në Shqipëri në çdo vend, siç kemi të drejtën të tërheqim pagën tonë në çdo bankomat të bankave në Shqipëri, në mënyrë që të mos i torturojmë në sportele. Të paktën të jepet si rekomandim.

E dyta që kërkova, gjë për të cilën shumë mirë Drejtoria e Përgjithshme e Postave me politikat e saj të shërbimeve dhe me shtesën e shërbimeve ndaj qytetarëve që lidhet me projektin pilot, që po zbatohet në Durrës ku në të gjithë sportelet e postave përfitohen të gjithë benefitet që gjenerohen nga vendimmarrja e këshillave të bashkive lidhur me ndihmat ekonomike, shpërblimet e ndryshme, prandaj ripropozoj që këto propozime të jenë si rekomandime, me qëllim që të shtohen shërbimet për të lehtësuar përfituesit pensionist dhe shtresat vulnerabël që përfitojnë nga këto 2 shërbime.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Në fakt, ajo çfarë ne i rekomandojmë AKEP-it në lidhje me Postën Shqiptare që na lejon ta bëjmë këtë gjë është fakti se Posta Shqiptare nuk zbatonte një detyrim ligjor, në bazë të ligjit që operon për dorëzimin e postave në adresën finale. Këtë kishte për detyrë AKEP-i, që të shtynte dhe të kontrollonte zbatueshmërinë ligjore. Propozimet tuaja kanë të bëjnë me aktivitetin e drejtpërdrejt të Postës Shqiptare për të cilën nuk ndërhyt dot AKEP-i, që t'i tregojë Postës Shqiptare nëse duhet ta bëjë këtë hap apo nuk duhet ta bëjë; duhet pasur parasysh që është ent rregullator dhe nuk ndërhyt dot në aktivitetin e përditshëm. Pra, në lidhje me Postën Shqiptare rekomandimet tona që kanë qenë disa vite dhe më në fund janë realizuar, kanë pasur të bëjnë me moszbatimin e një detyrimi ligjor të Postës Shqiptare, por jo me aktivitetin e postës. Këtë tha atë ditë edhe drejtuesi i AKEP-it: ky është një aktivitet që posta mund ta bëjë ose jo, këtë e shikon vetë. Këtë gjë ne mund ta diskutojmë. Nëse keni këtë shqetësim ne thërrasim pronarin e postës, që është ministria dhe t'i sugjerojmë këtë apo atë, por jo AKEP-in, sepse nuk ndërhyt dot; edhe pse unë i gjej me vend disa nga shqetësimet tuaja. Në lidhje me pensionet, askush nuk pengon askënd që t'i marrë qoftë te posta, qoftë në bankat e nivelit të dytë, pra kudo që ata dëshirojnë; pensionet transferohen dhe mund t'i tërheqin. Megjithatë nuk jemi në kushtet e këtij diskutimi, jemi në kushtet kur ne i rekomandojmë AKEP-it se ku duhet të përqendrohet në aktivitetin e tij për vitin që vjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e ka AKEP-i drejtpërdrejt, por AKEP-i ushtron një lloj presioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Heqja e “rrjetave të merimangës” nuk ka të bëjë me aktivitet ekonomik ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Faleminderit!

Po, zoti Mziu.

Xhelal Mziu – Më vjen mirë që u morën në konsideratë sugjerimet e bëra nga kolegët, por unë shikoj edhe 2 gjëra të tjera që realisht duhet të gjejnë vend.

E para, ka të bëjë me disa hotspote, që u diskutuan edhe në praninë e drejtuesit të ftuar atë ditë, pra u ngrit që kemi zona që ndoshta nuk kanë popullsi me dendësi të lartë, ku nuk ka jo vetëm internet, por as komunikim. Pra, dua të lihet si detyrë që brenda këtij viti të eliminohen në maksimumin e mundshëm zonat që nuk kanë linjë komunikimi. Po bëj pak analogji: t'i je me makinë, hap radion në Durrës dhe kap radiot italiane; shkon në pjesën veriore del radio e Malit të Zi, apo në pjesën jugore del radio e Greqisë. Pra, besoj se është momenti kur duhet ndërhyrë për këtë.

Gjithashtu, kur shkojmë me telefon në disa zona del telefoni i vendeve fqinje, pra unë e shikoj me vend që në aspektin social, por edhe në aspektin e hotspoteve, nuk janë të pakta dhe kjo ndikon negativisht te qytetarët. Pra, të mos rendim pas zonave me dendësi të lartë, por të bëhen investime ekstensive për të kapur edhe në zona që kanë pak popullsi, por që duhen trajtuar si konsumatorë, siç është edhe pjesa tjetër.

E dyta, meqenëse janë 2 operatorë në treg, duhet patjetër që të shikohet edhe në raport me vendet e tjera, sepse ulja e tarifës duhet të jetë prioritare, nuk besoj se ka institucion tjetër më shumë sesa AKEP-i që mund ta luajë këtë rol.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Zoti Mziu, faleminderit!

Në fakt, ky është një shqetësim i drejtë juaji, por është një shqetësim nga të dy krahët e kufirit. Pra, edhe këtej nga ne hyjnë sinjale, por edhe nga ata hyjnë sinjalet tona. Në përgjithësi këto rregullohen me marrëveshje dypalëshe. Ne kemi sugjeruar për bashkëpunime ndërkufitare me Republikën e Maqedonisë së Veriut, me të cilën duhet të rakordojmë disa gjëra në lidhje me brezat 4G dhe 5G, për 700 dhe 800 nuk kemi arritur akoma një marrëveshje që AKEP-i duhet të punojë. Për pjesën e hotspoteve ju keni të drejtë, e diskutuam edhe me drejtuesit e AKEP-it. AKEP-i mund t'i shtyjë kompanitë, por nuk i detyron dot të bëjnë investime në zonat që nuk janë rentabël. Ajo që menduam se është më e rëndësishmja për të gjithë ne është të paktën të mos kemi shkolla pa internet. Propozimin tënd e çmuam të rëndësishëm, pavarësisht faktit nëse ka

apo jo fizibilitet, por që të çosh internetin në një zonë të caktuar, nuk i duhet hyrë këtij diskutim, kur bëhet fjalë për shkolla. Shkolla duhet të ketë internetin, pavarësisht faktit nëse ka 900 nxënës apo 90 nxënës. Ne e dimë që mund të kemi, por jo çdo gjë që dëshirojmë mund ta sugjerojmë, sepse disa gjëra janë të pamundura për t'u realizuar. Dakord.

Hedhim në votim draftrezolutën. Kush është dakord me draftrezolutën, me sugjerimet që i bëjmë AKEP-it për vitin 2022? Kundër? 6 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Mbledhja tjetër do të njoftohet.

MBYLLET MBLEDHJA